

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR POGRADEC**

Nr. regj. 27

Nr. vend. 69

Data e regj. 12.02.2020

Dt. e vend 12.05.2020

**V E N D I M**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

**Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec e përbërë prej: GJYQTAR:**

{xxx}

Asistuar nga sekretares gjyqësore {xxx}, sot më datë 12.05.2020, ora 09:30, mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit, çështjen penale që i përket:

**KERKUES:** {xxx} e bija e {xxx} dhe {xxx}, lindur më {xxx}, banuese në Pogradec, mbajtëse e pasaportës italiane Nr. {xxx} dhe pasaportën shqiptare Nr. {xxx}. mbrojtur në gjykim nga av. {xxx}, antar i Dhomës së Avokatisë Korçë, me prokurë.

{xxx}, e bija e {xxx} dhe e {xxx}, lindur më {xxx} banuese në Pogradec, mbajtëse e pasaportës shqiptare Nr.{xxx} mbrojtur në gjykim nga av.{xxx}, antar i Dhomës së Avokatisë Korçë, me prokurë.

{xxx}, i biri i {xxx} lindur më {xxx} shtetas Italina identifikuar me pasaportën italiane Nr.{xxx} mbrojtur në gjykim nga av.{xxx}, antar i Dhomës së Avokatisë Korçë, me prokurë.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, përfaqësuar në gjykim nga prokuror {xxx}.

**P.TRETË:**

**OBJEKTI:**

Revokimin e masës së sigurimit pasuror “sekuestro preventive” të caktuar me vendimin nr.113, dt.05.07.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, për pasuritë e shtetasve {xxx}, {xxx} dhe {xxx}.

**BAZA LIGJORE:** Neni 274/3 i K. Pr. Penale.

*i-*

Gjykata pasi shqyroi kërkesën dhe u njoh me provat e administruara ne seancë gjyqësore lidhur me këtë çështjen penale;

## V Ë R E N S E :

### I- RRETHANAT E ÇËSHTJES/PRETENDIMET E PALËVE

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec me vendimin nr.1 13, dt.05.07.2019 ka vendosur sa më poshtë:

Caktimin e masës së sigurimit pasuror “*sekuestro preventive*” mbi pasuritë e paluajtshme të shtetases {xxx} , {xxx} dhe {xxx} , si për pasuritë e paluajtshme edhe për ato të porositura:

I. Pasuri të regjistruara në Agjensinë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Pogradec.

1. Pasuria me nr. 1/427+3-188, ZK8581, vol 34, fq 225, ZK 8581 ndodhur në Bulevardin “Dëshmorët e Pojskës”.
2. Pasuria me nr. 1/427+3-189, ZK8581, vol 34, fq 226, ZK 8581 ndodhur në Bulevardin “Dëshmorët e Pojskës”.

II. Pasuri të porositura (apartament+njësi shërbimi) nga shtetësia {xxx} , me kontratën e sipërmarrjes nr.2780 rep, nr.1270 kol, dt. 18/06/2018 e lidhur para noterit {xxx} në objektin “Godinë banimi+ shërbimi” që është ndërtuar nga shoqëria “Arlis+ Ndërtim” në qytetin e Tiranës, shpk mbi bazën e lejës së ndërtimit miratuar me vendimin nr.x- 1504, dt.21 /02/2017 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë.

1. Pasuria nr.5.4.10 e llojit apartament 2+1 me sipërfaqe totale 104.1 m2 në katin e katërt, shkalla 5.
2. Pasuria e dytë e porositur me këtë kontratë është apartament me nr.5.4.11 e llojit apartament 2+1 me sipërfaqe 127.3 m2 në katine kaër, shkalla 5
3. Pasuria e tretë e porositur me këtë kontratë është apartament me nr.4.3.6 e llojit apartament 1+1 me sipërfaqe totale 75.5 m2 në katin e tretë, shkalla 4.
4. Pasuria e katërt e porositur me këtë kontratë është apartament me nr.4.3.1 e llojit “apartament” +1 me sipërfaqe 75.4 m2, në katin e katërt shkalla 4.
5. Pasuria e pestë e porositur me këtë kontratë është njësi shërbimi e ndodhur në katin përdhe me sipërfaqe 106.3 m2.

Me ekzekutimin e këtij vendimi për vendosjen e sekuestros të ngarkohet OPGJ {xxx} dhe Leonart Qorri pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit si dhe Agjensia e Kadastrës Shtetërore, Drejtoria Vendore Pogradec për pasuritë e përmendura në numrin romak “I” dhe Agjensia e Kadastrës Shtetërore, Drejtoria Vendore Tiranë. për pasuritë e përmendura në numrin romak “II”

Kundër këtij vendimi palët e interesuara mund të bëjnë ankim në Gjykatën e Apelit Korçë, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në K.Pr.Penale.

Dy kopje të këtij vendimi t’i vihen në dispozicion Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

2. Kërkuesit kërkojnë heqjen e masës së sigurimit pasuror, pasi mbi bazën informacioneve të marra nga autoritetet Italiane kishte nisur një hetim ndaj shoqërisë {xxx} në pronësinë e {xxx} dhe {xxx} për kryerjen e veprave penale. Referuar vendimit nr.25353.2018 RGNR, nr.6213/18 RG GIP dt.26.11.2019 të Gjykatës së Italisë, Gjykata e Zakonshme në Milano, rezulton se, kërkuesit janë dënuar për prodhimin e veshjeve të {xxx} pasi licensa që shoqëria e tyre kishte për prodhimin e këtyre veshjeve “Firmë” kishte përfunduar.

3. Për shkak të dëmit që i është shkaktuar kompanisë {xxx} kërkuesit janë dënuar me nga një vit e gjashtë muaj burgim i cili është pezulluar, gjithashtu {xxx} është dënuar me 4.000 euro gjobë, ndërsa {xxx} me 3.200 euro gjobë, ndërsa shoqëria është dënuar me 20.000 euro gjobë.

4. Kërkuesit pretendojnë se, dyshimet fillestare kanë qenë të mëdhaja, për veprën penale “Pastrimit të produkteve të veprës penale” ndërsa në përfundim të hetimit është arritur në përfundimin se, kemi të bëjmë më tepër me një konflikt civil se sa penal. Prokuroria dhe Gjykata Italiane nuk kanë marrë masa për konfiskimin e pasurive. Në kushtet kur, procesi hetimor që ishte nisur në shtetin Italian, shërbeu si bazë për nisjen e procedimit penal edhe në R.SH i cili nisi me sekuestrimin e disa personave dhe në vijim përfundoi me dënime të buta, fakti që nuk është vendosur donjë konfiskim pasurie ndaj kërkuesve, nuk është llogjikshme që pasuritë të mbahen të sekuestrura nga autoritetet e drejtësisë shqiptare.

5. Kërkuesit pretendojnë se kompania e tyre {xxx} ka një xhiro të konsiderueshme, referuar bilanceve të kësaj shoqërie për vitin 2017 të ardhurat nga shitja dhe shërbimet janë në shumën 6.242.102 euro, për vitin 2016 të ardhurat nga shërbimi dhe shitja është janë në shumën 6.263.448 euro, ndërsa për vitin 2015 janë 4.885.762. Pala kërkuese i ka paraqitur bashkëlidhur kërkesës disa kontrata tregëtare me shoqëri të ndryshme.

6. Kërkuesit pretendojnë se, ushtrojnë aktivitetin kryesisht në Amerikën Latine dhe në Azi, u tregëton dhe prodhon rroba e aksesorë për firmat më në zë të modës, duke përfshirë edhe shtetin e Panamasë që ka lehtësira fiskale. Paratë e investuara në Shqipëri janë sjellje në mënyrë të ligjshme, nëpërmjet transaksioneve bankare të cilat kanë qenë objekt i verifikimit nga Drejtoria e Parandalimit të Pastrimit të Parave.

7. Referuar kontratës së sipërmarrjes me nr.2780 rep, nr.1270 kol, dt. 18.06.2018 mbi bazën e të cilës janë porositur 5 apartamente nga shoqëria “Arlis Ndërtim” shpk, referuar nenit 2, 2.2, 2.2.3 dhe 2.3 nëse porositësi nuk do të përmbushte detyrimin, për të paguar pjesën e ngelur të vlerës së apartamenteve, sipërmarrësi ka të drejtën e zgjidhjes së menjëhershme të kontratës. Masa e sigurimit e vendosur nga gjykata i sjell një dëm të rëndë kërkuesve, zgjidhjen e kontratës së sipërmarrjes.

8. Prokuroria mbajti qendrimin se, nuk jemi përpara veprës penale të pastrimit të produkteve të veprës penale, nuk rezulton që kërkuesit të kenë përdorur ndonjë mekanizëm për fshehjen e origjinës së pasurisë të krijuara nga të burime të paligjshme, në kuptim të formave që parashikon neni 287 i K.Penal. Kërkuesit ushtrojnë aktivitet tregëtar në shtetin e Italisë, që ka të ardhura vjetore rreth 6 milion euro, e cila justifikon pasuritë e krijuara në shtetin Shqiptar, për te cilat është vendosur sekuestrimi.

## II. VLERËSIMI GJYAKTËS

9. Gjykata vlerëson se, pasuritë e sekuestruara me vendimin nr.1 13, dt.05.07.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, konkretisht dy apartamente në qytetin e Pogradecit dhe pesë apartamente të prenotuara në qytetin e Tiranës, në emër të kërkuesve, nuk burojnë nga veprimtari kriminale apo nuk janë pastrim i produkteve të veprës penale në kuptim të nenit 287 të K.Penal.

10. Kjo për arsye se, nga të dhënat tregëtare që përmbahen në dokumentat zyrtare të shtetit Italian që lidhen me veprimtarinë tregëtare të kërkueses {xxx} (administratoria e kompanisë “Almy”) rezulton se të ardhurat nga shitja dhe shërbimet për vitin 2017 janë në shumën 6.242.102 euro, për vitin 2016 të ardhurat nga shërbimi dhe shitja është janë në shumën 6.263.448 euro, ndërsa për vitin 2015 janë 4.885.762.

11. **Referuar, pikës 15 të** vendimit nr.113, dt.05.07.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, ka rezultuar se, nga aktet e paraqitura nga prokuroria dhe që ndodhen në fashikullin e gjykimit rezulton se, pas administrimit të të dhënave bankare, në llogaritë bankare në euro të shtetases {xxx} , në Raiffaisen Bank në periudhën 16/08/2016- qershor 2018 janë transferuar rreth 153 mijë euro, ndërsa në llogarinë të po kësaj shtetase në Tirana Bank në periudhën kohore tetor 2017- qershor 2018 janë transferuar një shumë prej 46.500 euro.

12. Të gjitha transfertat në llogarinë bankare të kësaj shtetase janë kryer nga shtetasi Italian {xxx} Cocilvolo si dhe nga kompania “Gynarai Holding Corps” e cila e ka veprimtarinë në shtetin e Panamasë e cila konsiderohet “parajsë fiskale” nga një sërë organizatash ndërkombëtare.

13. **Po kështu referuar pikës 17 të** vendimit nr.113, dt.05.07.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, ka rezultuar se, nga aktet e fashikullit të procedimit penal që ndodhen në dosjen gjyqësore, rezulton se, shtetasia {xxx} dhe shtetasi Italian {xxx} Cocilov me kontratat nr.405 rep, nr.148 kol, dt.21/12/2016 të lidhur para noterit Erjon Bardhi, ka blerë një apartament banimi me sipërfaqe 74.4 m2 ndodhur në Bulevardin “Dëshmorët e Pojskës”, konkretisht pasuria me nr. 1/427+3-188, ZK 8581.

14. Ndërsa me kontratën me nr.404 rep, nr.147 kol, dt.21.12..2016 të lidhur para noterit {xxx} ka blerë një apartament banimi me sipërfaqe 97.61 m2, ndodhur në Bulevardin “Dëshmorët e Pojskës” konkretisht pasurinë me nr.1/427+3-189, ZK 8581. Vlera e apartamentit të parë me sipërfaqe 74.4 m2 sipas kontratës është 26.750 euro dhe për apartamentin me sipërfaqe 97.61 m 2 me kontratën e dytë është 34.587 euro. Më pas apartamentin prej 97.6\ m2 konkretisht pasurinë me nr. 1/427+3-189, ZK 8581 i’a kanë dhuruar shtetases {xxx} e cila është nëna e Almandës.

15. **Po kështu referuar pikës 18 të** vendimit nr.113, dt.05.07.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, ka rezultuar se, në emër të shtetases {xxx} ekziston edhe një automjet tip Mercedes Benc prodhim i vitit 2008 me targë {XXX} të cilën e ka blerë nga

shtetasi Renato Seitllari me kontratën nr.2555 rep, nr.1154 kol, dt.06/06/2018 e lidhur para noterit {xxx} në vlerën 1.830.000 lekë.

19. **Po kështu referuar pikës 19 të** vendimit nr.113, dt.05.07.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, ka rezultuar se, me kontratën e sipërmarrjes nr.2780 rep, nr.1270 kol, dt. 18/06/2018 e lidhur para noterit {xxx} shtetësia {xxx} me cilësinë e porositësit ka porositur te shoqëria “Arlis Ndërtim” shpk pesë njësi pasurie të paluajtshme në vlerën totale 693.000 euro, në qytetin e Tiranës. Në kontratën në fjalë janë përshkruar pasuritë si më poshtë:

- Pasuria nr.5.4.10 e llojit apartament 2+1 me sipërfaqe totale 104.1 m<sup>2</sup> në katin e katërt, shkalla 5.
- Pasuria e dytë e porositur me këtë kontratë është apartament me nr.5.4.11 e llojit apartament 2+1 me sipërfaqe 127.3 m<sup>2</sup> në katine kaër, shkalla 5  
Pasuria e tretë e porositur me këtë kontratë është apartament me nr.4.3.6 e llojit apartament 1+1 me sipërfaqe totale 75.5 m<sup>2</sup> në katin e tretë, shkalla 4.  
Pasuria e katërt e porosituar me këtë kontratë është apartament me nr.4.3.1 e llojit “apartament” +1 me sipërfaqe 75.4 m<sup>2</sup>, në katin e katërt shkalla 4.  
Pasuria e pestë e porositur me këtë kontratë është njësi shërbimi e ndodhur në katin përdhe me sipërfaqe 106.3 m<sup>2</sup>.

20. Për sa u tha më sipër, rezulton se, vlera e pasurive të blera e të porosituara në një interval shumë të shkurtër arrin në një vlerë të konsiderueshme prej 750.000 euro. Ndërkohë rezulton se në llogaritë bankare të shtetases {xxx} në Tirana Bank dhe Raiffaisen Bnak janë kredituar gjatë këtyre viteve shuma rreth 200.000 euro nga të cilat rezulton se një pjesë janë kaluar me urdhërues shtetasin {xxx} {xxx} si dhe pjesa tjetër nga llogaritë bankare të një kompanie në Panama të quajtur “Gynarai Holding Corps”.

21. Gjykata, duke u nisur nga fakti se, shoqëria {xxx} në pronësinë e {xxx} dhe {xxx} {xxx} , gjatë vitit 2016-2018 ka pasur të ardhura të realizuara në një shifer totale 17 milion euro, që përkohë me periudhën që janë kryer transaksionet financiare në llogaritë bankare, janë blerë apo porositur apartamentet në qytetin e Pogradecit dhe Tiranës, gjykata vlerëson se, transfertat bankare në vlerën reth 200.000 euro dhe pasuritë e blera dhe të prenotuara kapin një shifër 750.000 euro, mbulohen nga qarkullimi financiar i shoqërisë {xxx} me shifra disa herë më të larta nga këto pasuri të sekuestrura.

22. Rezulton nga kontrata tregëtare bashkëlidhur kërkesës të cilat janë përkthyer, noterizuar, shoqëruar edhe me konfirmime zyrtare nga ambasadat e vendeve respektive se, shoqëria {xxx} në pronësinë e {xxx} dhe {xxx} {xxx} nga viti 2009 e në vazhdim ka hyrë në marrëdhënie me shoqëri tregëtare që operojnë në vendet e Amerikës Latine, për tregëtimin e veshjeve.

23. Konkretisht konstatohen këto kontrata tregëtare:

- Marrëveshje Brokëri midis shoqërisë {xxx} dhe shoqërisë “KENZO” e themeluar në shtetin Francez, dt.07.03.2012 e cila ka objekt shitjen e veshjeve me pakicë nga kjo e fundit në vendet e Amerikës Latine. (Në pikën 1 të kontratës thuhet se, shoqëria “Kenzo” është e famshme në të gjithë botën për ekskluzivitetin dhe unikalitetin e produkteve të saj të shkallës më të lartë të inovacionit, në pikën 3 thuhet se, Kenzo dëshiron rritjen e klientëve të

saj për produktet dhe aksesorët e gatshëm, në tregjet e Amerikës së Jugut dhe Amerikës Qendrore).

- Marrëveshje tregëtare midis shoqërisë {xxx} dhe shoqërisë {xxx} dt. 14.10.2011. Kompania {xxx} merr përsipër shitjen e veshjeve për llogari të shoqërisë kontraktuese, duke përfituar pjesën e përqindjes të përcaktuar në kontratë, duke pasur si qëllim rritjen e klientelës së shoqërisë kontraktuese të përmendur më sipër. Kontrata është lidhur në shtetin Italian dhe tregëtimi i produkteve do të bëhet në Amerikën Latine.

24. Kontatat e përmendura më sipër, tregojnë se, shoqëria {xxx} kryen aktivitet tregëtar duke hyrë në marrëdhënie me shoqëri tregëtare të njohura në tregun e veshjeve në rang ndërkombëtar dhe që qarkullojnë vlera të mëdha monetare.

25. Gjykata vlerëson se, kërkuesit {xxx} dhe {xxx} {xxx} pronarët e shoqërisë {xxx} pasuritë e sekuestruara, nuk i kanë vendosur në kuadër të donjë veprimtarie kriminale, por si rrjedhojë e ushtrimit të aktivitet tregëtar të përmendur më sipër.

26. Ky përfundim përforcohet edhe nga vendimi nr.25353.2018 RGNR, nr.6213/18 RG GIP dt.26.11.2019 të Gjykatës së Italisë e cila nuk ka vendosur konfiskim mbi pasuritë e kërkueseve të cilat i kishte sekuestruar paraprakisht nga gjykata, në një vlerë prej 2.388.611 euro. Rezulton se, Gjykata Italiane e qytetit të Milanos i ka dënuar me kusht dhe dënim me gjobë kërkuesit {xxx} dhe bashkëshortin e saj {xxx} {xxx} për veprën penale “Mashtime financiare” “Falsifikime dokumentash” “Përdorimi i markës që i përket një tjetri”, **por nuk ka konfiskuar pasurinë e tyre, që do të thotë se, nuk i ka konsideruar si asete kriminale.**

27. Perderisa, nuk është konsideruar si aset kriminal shuma prej 2.388.611 euro e sekuestruar paraprakisht nga gjykata e shtetit Italian, nuk ka sens të konsiderohet si produkt i veprës penale pasuria e sekuestruar në shtetin Shqiptar (apartamente, automjete) që përlllogariten përafërsisht në një vlerë prej 750.000 euro. Për më tepër, procedimi penal në shtetin shqiptar ka filluar, për shkak të procedimit penal që ka nisur në shtetin Italian dhe faktin që ishin vendosur sekuestro në vlerën prej 2.388.611 euro në këtë shtet.

28. Për sa u tha më sipër, gjykata vlerëson se, pasuria e sekuestruar me vendimin nr.113, dt.05.07.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, nuk përbën produkt të veprës penale në kuptim të nenit 287 të Kodit Penal. Nuk ekzistojnë dyshime të arsyeshme të bazuara në prova se, kërkuesit janë përfshirë në veprimtari kriminale, mbi bazën e të cilave kanë siguruar pasuritë e sekuestruara.

## **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata bazuar në nenet 274/3 të K.Pr.Penale, nenin 287 të Kodit Penal

**VENDOSI:**

Pranimin e kërkesës së kërkuessve {xxx} , {xxx} dhe {xxx} , për heqjen e sekuestros preventive të caktuar me vendimin nr.1 13, dt.05.07.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

Kundër këtij vendimi palët e interesuara mund të bëjnë ankim në Gjykatën e Apelit brenda 15 ditëve nga data e nesërme e shpalljes së këtij vendimi.

**U shpall sot në Pogradec, më datë 12.05.2020**

**SEKRETARE  
DIONA PALLA**



**GJYQTARI ARTAN  
JAHOLLARI**



**Shenim:** Vendimi mori forme te prere ne dt.28.05.2020

**Kancelari**

**Guri Sofi**



t